



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2020:029292
Datë: 21.06.2024
Numri i dokumentit: 05842840

Ac.nr.2159/2022

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS, në kolegjin e përbërë nga gjykatësit: Dr.sc. Rafet Haxhaj, kryetar dhe Naime Ahmeti e Fatmir Baloku anëtarë, me zyrtaren ligjore Fitore Isufi-Saraçi, në çështjen kontestimore të paditëses H. A nga Gjilani, të cilën me autorizim bartës e përfaqëson M. H avokate nga Vitia, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit–Drejtoria Komunale e Arsimit, të cilën e përfaqëson përfaqësuesi i saj me autorizim Burim Maliqi, jurist nga Gjilani, për kompensimin e shpërblimit jubilar, shpenzimeve të ushqimit dhe të udhëtimit, duke vendosur sipas ankesës së të paditurës, e paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.528/2020 të datës 19.11.2021, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë 18.06.2024, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pa bazuar, ankesa e të paditurës Komuna e Gjilanit, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Gjilan, C.nr.528/2020 i datës 19.11.2021, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Me aktgjykimin e atakuar të gjykatës së shkallës së parë, në pikën I., të dispozitivit aprovohet si e bazuar kërkesëpadia e paditëses H. A nga Gjilani, kundër të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit dhe detyrohet e paditura, që paditëses t'i paguajë në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, shumën e të hollave në lartësi prej 421.00€, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shumën prej 1,330.00€, si dhe për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 456.50€, respektivisht shumën përgjithshme të të hollave në lartësi prej 2,207.50€, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%, duke e llogaritur nga dita e paraqitjes së kësaj padie e deri në pagesën përfundimtare, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përbarimit të dhunshëm. Në pikën II., të dispozitivit obligohet

e paditura Komuna e Gjilanit që paditëses H. A t'ia paguajë shpenzimet e procedurës në lartësi prej 260€.

Kundër këtij aktgjykimi, brenda afatit ligjor ankesë ka paraqitur edhe pala e paditur, për shkak të shkeljes thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, konstatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike, me propozim që të aprovohet ankesa e të paditurës si e bazuar, të priset aktgjykimi i atakuar dhe të kthehet çështja në rivendosje në gjykatën e shkallës së parë, apo të ndryshohet aktgjykimi i atakuar dhe të refuzohet në tërësi padia dhe kërkesëpadija në këtë çështje juridike.

Gjykata e Apelit si gjykatë e shkallës së dytë, pas vlerësimit të pretendimeve ankimore lidhur me aktgjykimin e atakuar, në mbështetje të dispozitës së nenit 194, 195 dhe 200 të Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ka gjetur se:

Ankesa është e pa bazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedhë se paditësja H. A ka parashtruar padi ndaj të paditurës Komuna e Gjilanit-Drejtoria Komunale e Arsimit, me të cilën ka kërkuar që të detyrohet e paditura që paditëses t'i paguajë në emër të kompensimit të shpërblimit jubilar, shumën e të hollave në lartësi prej 421.00€, në emër të kompensimit të shpenzimeve të ushqimit, shumën prej 1,330.00€, si dhe për shpenzimet e udhëtimit shumën prej 456.50€, respektivisht shumën përgjithshme të të hollave në lartësi prej 2,207.50€, me kamatë ligjore në lartësi prej 8%.

Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjendjen faktike se: paditësja H. A së bashku me të paditurën Komuna e Gjilanit, janë në marrëdhënie pune, ku paditësja si punëmarrëse ushtron aktivitetin e saj punues si mësimdhënëse të SH.F.M.U. "..."-... E njëjta që nga momenti i hyrjes në fuqi të Kontratës Kolektive të Arsimit, pra nga dt. 18.04.2017 e deri më dt. 09.03.2020, paditësja ka realizuar gjithsej 665 ditë pune, dhe për ta realizuar aktivitetin e saj, paditësja ka udhëtuar nga Gjilani për në ... për çdo ditë. Paditësja për aktivitetin e saj të punës tek e paditura, shpërblehet me pagë prej 485.57€ neto në muaj, kurse paga e saj bazë është 421.00€. Gjykata e shkallës së parë ka vërtetuar gjithashtu se e paditura Komuna e Gjilanit nuk i ka bërë pagesat paditëses lidhur me të drejta që burojnë nga Kontrata Kolektive.

Gjykata e shkallës së parë ka vendosur si në dispozitivin e aktgjykimit të atakuar me ankesë.

Baza ligjore:

Neni 194 i LPK-së: “Gjykata e ankimit ekzaminon aktgjykimin e shkallës së parë në atë pjesë në të cilën është goditur me ankesë dhe atë brenda kufijve të shkaqeve të treguara në ankesë, duke u kujdesur sipas detyrës zyrtare për zbatimin e së drejtës materiale si dhe për shkeljen e dispozitave të procedurës kontestimore nga neni 182 paragrafi, pika b), g), j), k), dhe m) të këtij ligji”.

Neni 195.1 i LPK-së: “Gjykata e ankimit mundet, në seancën e kolegjit apo në bazë të shqyrtimit të çështjes të bërë drejtpërdrejt para saj:d) ta refuzojë ankesën si të pa themeltë dhe ta vërtetojë aktgjykimin e goditur”.

Vlerësimi i Gjykatës së Apelit:

Gjykata e Apelit e aprovon vlerësimin juridik të gjykatës të shkallës së parë si të rregullt dhe të ligjshëm sa i përket vendosjes si në dispozitiv të aktgjykimit të atakuar, për arsye se i njëjti nuk është përfshirë me shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore, të pretenduara dhe as në shkeljet nga neni 182 par.2, pika b), g), j), k) dhe m), të LPK-së, dhe rrjedhimisht nuk ka aplikim të gabuar të drejtës materiale për të cilat gjykata kujdeset sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së.

Kolegji gjen se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore të paditurës se aktgjykimi është përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave të procedurës kontestimore. Sipas vlerësimit të Gjykatës së Apelit, dispozitivi i aktgjykimit të atakuar është i qartë dhe në përputhje të plotë me arsyet e aktgjykimit, duke qenë kështu në harmoni logjike dhe juridike dispozitivi me arsyetimin. Gjykata ka arsyetuar të gjitha faktet me peshë vendimtare për themelësinë e kërkesëpadisë e në lidhshmëri me këtë ka arsyetuar mënyrën se si janë vërtetuar faktet, përveç atyre jo kontestuese e gjithashtu edhe mënyrën se si i ka vlerësuar provat për secilin fakt të provuar. Gjendja faktike është vërtetuar në mënyrë të drejtë dhe disa fakte vendimtare nuk kanë qenë kontestuese.

Kolegji i Gjykatës së Apelit gjen se, nuk qëndrojnë pretendimet ankimore se gjykata e shkallës së parë gabimisht ka aplikuar të drejtën materiale për arsyeje se me nenin 90 paragraf 1 të Ligjit të Punës 03/L-212 i datës 01.11.2010, përcaktohet se: *“Marrëveshja Kolektive mund të lidhet: a) organizatës së punëdhënësve ose përfaqësuesit të tij, dhe b) organizatës së të punësuarve ose kur nuk ekzistojnë organizata, marrëveshjen mund ta lidhin edhe përfaqësuesit e të punësuarve.* Me paragrafin 1 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive mund të lidhet a) në nivel të vendit, b) në nivel të degës dhe c) nivel të ndërmarrjes. Me paragrafin 3 të këtij neni përcaktohet se Marrëveshja Kolektive duhet të jetë në formë të shkruar, në Gjuhën Zyrtare të Republikës së

Kosovës. Me paragrafin 4 përcaktohet se Marrëveshja Kolektive vlen për ata punëdhënës dhe punëmarrës të cilët marrin për sipër detyrimet e përcaktuara me marrëveshjen e tillë kolektive”.

Me nenin 35 paragraf 8, të Kontratës Kolektive të datës 18.04.2017, përcaktohet se: *“Punëtorët (anëtarët e SBASHK-ut) në vitet jubilarë të punësimit përfitojnë shpërblimin jubilar nga punëdhënësi i fundit, në vlerë: 8.1) për 10 vjet të përvojës së punës te punëdhënësi i fundit në vlerë të 50% të një page bazë, 8.2) për 20 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të 75% të një page bazë, 8.3) për 30 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të një page bazë, 8.4) për 40 vjet të përvojës së punës të punëdhënësi i fundit në vlerë të 150% të një page bazë, 8.5) shpërblimi jubilar paguhet nga punëdhënësi, kur i punësuar i ka plotësuar kushtet e shpërblimit sipas kriterëve përkatëse dhe 8.6) shpërblimi jubilar paguhet në rastin e 7 Marsit të çdo viti . Me nenin 35.7 të Kontratës Kolektive përcaktohet se: *“Të punësuarve u sigurohet kompensim për ushqim gjatë punës, për ditët e pranisë në punë. Vlera e kompensimit të shpenzimit të ushqimit në punë, për një ditë pune është 2 euro për të punësuarit që kanë marrëdhënien e punës primare në institucionet arsimore. Punëdhënësi, i cili ka të rregulluar ushqimin e të punësuarve, përmes restorantit a kuzhinës, ose në një formë tjetër, nuk ka obligim kompensimin për ushqim”*. Ndërsa me nenin 35.5 të po të njëjtës Kontratë përcaktohet se: *“Punonjësit arsimor që udhëtojnë në vendbanimet e Komunës përkatëse ku punojnë i paguhen shpenzimet e rrugës 70% të biletave të trafikut urban”*.*

Sipas vlerësimit të kolegjit, gjykata e shkallës së parë me rastin e aprovimit të kërkesëpadisë së paditëses, duke e detyruar të paditurën që paditëses t’ia paguaj në emër të pagesës së shpërblimit jubilar, për ushqim dhe udhëtim me të drejtë është bazuar në nenin 35 të Kontratës Kolektive të Arsimit me datë 18.04.2017 të lidhur dhe nënshkruar nga Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe Sindikata e Bashkuar e Arsimit, Shkencës dhe Kulturës. Këtë vlerësim të gjykatës së shkallës së parë në tërësi e mbështet edhe kolegji i gjykatës së shkallës së dytë dhe vlerëson se kjo kontratë ka qenë në fuqi në momentin kur ka lindur e drejta e paditëses që buron nga kjo kontratë dhe se e njëjta është në pajtueshmëri të plotë me nenin 90 Ligjit të Punës, nga rrjedh themelësia e kërkesëpadisë. Për arsyet e lartcekura kolegji, pretendimet ankimore të të paditurës i ka refuzuar si të pa bazuara, për faktin se nga shkresat e lëndës, në mënyrë të qartë është vërtetuar se paditësja është në marrëdhënie pune tek e paditura, ka përvojë mbi 30 vite, pagën bazë e ka 421€ dhe e njëjta udhëton në relacionin Gjilan – ... dhe anasjelltas, si dhe e njëjta ka 665 ditë të pranisë në punë.

Nga të lartë cekurat e në mbështetje të dispozitës së nenit 195.1 pika d), lidhur me nenin 200, të LPK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS NË PRISHTINË

Ac.nr.2159/2022, me datë 18.06.2024

Kryetari i kolegjit-gjykatësi,
Dr.sc. Rafet Haxhaj